

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture,
Omaladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosovo
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosijen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjit nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, palët nënshkruese janë pajtuar për të nënshkruar këtë:

MARRËVESHJE TË MIRËKËPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-së” NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale e përfaqësuar nga
z. Bislim Zogaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë

dhe

Komuna e Kaçanikut e përfaqësuar nga z. Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut

Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit nënshkruhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe të Komunës së Kaçanikut, me qëllim të përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësisë të financimit të projektit të përbashkët me titull: “RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-së” në Kaçanik.

Neni 2

Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

1. Projekti “RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-së” në Kaçanik, sipas planifikimit buxhetor ka koston financiare në total prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro).

2. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerën prej 20,000.00€ (njëzetë mijë euro), nga projekti “Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse dhe Memoriale, Varreza të Dëshmoreve dhe Martirve – Kosovë” me kod 14657 i paraparë në buxhetin e Agjencisë për vitin 2023.

3. Komuna e Kaçanikut financon këtë projekt në vlerën prej 30,000.00€ (tridhjetë mijë euro), nga kodi 45087, i paraparë në buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin 2023.

Neni 3

Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në pajtim me ligjin dhe këtë marrëveshje, zoton mjetet për projektin e paraparë në nenin 2 të kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e dërgon në Komunën e Kaçanikut për realizimin e projektit.

2. Pagesa për financimin e projektit **“RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-së”** në Kaçanik nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale do të ekzekutohet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Kaçanikut.

3. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale mund të caktoj një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit **“RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-së”** në Kaçanik, i cili do t'i raportojë Agjencisë.

Neni 4

Obligimet e Komunës

1. Komuna e Kaçanikut obligohet që për projektin **“RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-së”** në Kaçanik, në pajtim me ligjin të zhvilloj procedurat që kanë të bëjnë me procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

2. Komuna e Kaçanikut emëron Menaxherin dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

3. Komuna e Kaçanikut është e obliguar që të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për të gjithë hapat e realizimit të projektit.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Kaçanikut përfundon me realizimin e projektit.

Neni 6
Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes

1. Palët nënshkruese, zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast të kontestit eventual apo paqartësie për zbatimin e kësaj marrëveshje, pajtohen që përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim të gjendet zgjidhje përkatëse, e në të kundërtën pajtohen që për zgjidhjen e kontestit t'i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Për plotësimin dhe ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese pajtohen që të ndjekin rrugën e njëjtë si për nënshkrimin e marrëveshjes bazë.


Neni 7
Pronësia e projektit

1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky projekt i paraparë sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të regjistrohet në pronësi të Komunës së Kaçanikut.
2. Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës së Kaçanikut në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 8
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë identik dhe secila palë nënshkruese merr nga dy ekzemplarë.
2. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.


PALET NËNSHKRUERE TË MARRËVESHJES

Bislim ZOGAJ

Drejtor Ekzekutiv
Agjencia për Menaxhimin
e Monumenteve dhe
Komplekseve Memoriale



Datë: 17.05.2023

3 / 3

Besim ILAZI

Kryetar i Komunës
Komuna e Kaçanikut



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 29.05.23	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
07	105/02-12767	/